



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

Nr. 338 / Prot.

Datë 27.12 .2022

VENDIM

Nr. 940, Datë 27.12.2022

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllor (Ripërsëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor), ndaj ndërmarrjes Digitalb SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.122022 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllor (Ripërsëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor), ndaj ndërmarrjes Digitalb SHA.

Baza Ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42 pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, “ Mbi vlerësimin e ankesave të ndërmarrjes TV Kabllor Masa Group SHPK dhe operatorit kabllor Maxcom SHPK” .

VËREN SE :

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar ankesa e ndërmarrjes TV Kabllor Masa Group SHPK, nëpërmjet së cilës pretendohet një sjellje e parregullt e ndërmarrjes Digitalb SHA, e cila ka ndërprerë menjëherë bashkëpunimin në marrëdhënien juridike të detyrimit me Operatorin Kabllor Masa Grup SHPK për ripërsëritjen e programeve të Digitalb mbështetur në rrjetin kabllor (pretendim për zgjidhje të njëanshme e marrëdhënies juridike).

Në kuadër të vlerësimit të kësaj ankese u kërkuar informacion nga ndërmarrja ankimuese TV Kabllor Masa Grup SHPK, si dhe Autoriteti Mediave Audiovizive (AMA), në përgjigje të të cilave u depozitua dokumentacioni përkatës.

Gjatë vlerësimit të ankesës së ndërmarrjes TV Kabllor Masa Grup SHPK, pranë Autoritetit të Konkurrencës, u depozitua dhe ankesa e një tjetër Operatori Kabllor, ndërmarrjes Maxcom SHPK, e cila konsiston gjithashtu në sjelljen e parregullt në treg të Digitalb Sha.

Referuar ankesave të paraqitura, pretendohet se:

Ankimuesi TV Kabllor Masa Group SHPK ka hyrë në një marrëdhënie juridike detyrimi me TV Klan, nëpërmjet kontratës Nr.105 Prot., datë 26.01.2021, “Për ritransmetimin e paketës së programeve të TV Klan me anë të rrjetit kabllor”, me afat deri në 31 Gusht 2022.

TV Klan, gjatë zbatimit të kontratës, ka njoftuar ankimuesin se e drejta e ritransmetimit të paketës së kanaleve të TV Klan tek Operatorët Kabllor, i ka kaluar Digitalb SHA.

Pasi Digitalb SHA ka marrë të drejtën për ritransmetim të paketës, i ka dërguar TV Kabllor Masa Group SHPK “Propozim për Bashkëpunim”, sipas kushteve të përcaktuara nga vetë Digitalb SHA, për të dyja paketat Digitalb dhe TV Klan, por në vijim Digitalb SHA ka vendosur të ndërpresë bashkëpunimin me ankimuesin për ripërsëritjen e programeve të Digitalb.

Lidhur me sjelljen e Digitalb SHA, Operatori tjetër kabllor, TV kabllor Maxcom SHPK pretendon se, si rrjedhojë e zbatimit të marrëveshjeve të eskuzivitetit (exclusive dealing), nga ndërmarrja me pozitë dominuese Digitalb Sha me operatorët televizivë kombëtar pa pagesë, “.....asnjë televizion që është në transmetim me platformën Digitalb, përfshirë kanalet kombëtare Top Channel dhe TV Klan, nuk pranuan bashkëpunim, me argumentin se kanë kontratë transmetimi ekskluziv, nuk kanë të drejtë të bëjnë marrëveshje të tjera, sepse kanë nënshkruar me Digitalb”.

Bazuar sa më sipër, nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së vlerësimit të këtyre dy ankesave, rezulton se:

Aktualisht në Shqipëri sipas licencimit nga organi kompetent AMA, veprojnë dy platforma numerike satelitore Digitalb SH.A dhe TRING SH.A. Digitalb SHA, është operatori kryesor që vepron në televizionin me pagesë në Shqipëri.

Nga përpunimi i të dhënave të publikuara në ekstraktet e QKB-së, rezulton se, për vitin 2020 ndërmarrja Tring SHA ka 22 % pjesë tregu në bazë të xhiros së realizuar, ndërsa ndërmarrja Digitalb SHA ka 78 % pjesë tregu në bazë të xhiros së realizuar. Duke u nisur nga kriteri i pjesës së tregut, pjesa e tregut prej 78% e ndërmarrjes Digitalb, pra mbi 40%, bën që ndërmarrja të ketë pozitë dominuese përse i përket pjesëve të tregut, referuar nenit 8 të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Ndërkohë, në tregun e televizionit me pagesë veprojnë edhe operatorët kabllorë, të licencuar si ripërsëritës programi, të cilët transmetojnë vetëm nëpërmjet teknologjive që nuk mbështeten në frekuenca (kabëll, rrjet komunikimesh elektronike, IPTV etj). Këta

Operatorë Kabllorë ritransmetojnë kryesisht paketat Digitalb SHA, me kushtet e diktuar nga Digitalb SHA.

Në këto kushte, si një ndërmarrje me pozite dominuese në treg, Digitalb SHA, ka një detyrim të veçantë, të respektojë të drejtën e barazisë në ofrimin shërbimit për prodhimin, transmetimin dhe shitjen në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video kundrejt transmetuesve radioteleviziv kabllor, duke iu ofruar atyre shërbimet e tij me kushte të barabarta tregtimi.

Sjellja e ndërmarrjes Digitalb SHA, duke ndërprerë ofrimin e aksesit në platformën Digital për ritransmetimin e programeve televizive me anë të rrjetit kabllor, për operatorët kabllor, me pasojë kufizimin e ofrimit të këtyre shërbimeve nga Operatorët Kabllorë duke i vendosur ata në kushte të pabarabarta dhe të pafavorshme konkurrence në treg, mund të përbëjë një abuzim me pozitën dominuese të ndërmarrjes Digitalb SHA në tregun e TV me pagesë, në kundërshtim me nenin 9, të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Nga më lart vihet re gjithashtu se, ndërmjet operatorëve të kanaleve televizive dhe Digitalb SHA, është lidhur një marrëveshje ekskluzive për ritransmetimin dhe distribuicionin e programeve televizive. Në këtë mënyrë përmbajtjet pa pagesë të këtyre kanaleve televizive, bëhen gjithashtu pjesë e përmbajtjeve me pagesë në tregun e televizionit me pagesë me një cilësi të shtuar. Por, marrëveshjet e eskuzivitetit të zbatuara nga një ndërmarrje me pozitë dominuese si Digitalb Sha, me operatorët televizive pa pagesë, mund të çojnë në kufizime të ndjeshme të konkurrencës në tregun përkatës të TV me pagesë, në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma b) dhe d) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Referuar sa më sipër, lind dyshimi arsyeshëm se mund të jemi para një kufizimi të mundshëm të konkurrencës nga kjo ndërmarrje, në kuptim të nenit 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 4, nenit 9, nenit 24, shkronja d), si dhe nenit 42 pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:


1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë dixhitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllor (Ripërsëritësit e programeve mbështetur në rrejt kabllor), ndaj ndërmarrjes Digitalb SHA.
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2020 deri në 31.12.2022;
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 muaj nga marrja e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS


Leida MATJA


(_____)
Zv/Kryetar


Rezana KONOMI


(_____)
Anëtar

Adriana BERBERI


(_____)
Anëtar

Dufim KRAJA


(_____)
Anëtar

Denar BIBA


(_____)
Kryetar

